



REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 20 prill 2015  
Nr.ref.: 789/15

## VENDIM

për

**Rivendosjen e gjyqtarit Kadri Kryeziu**

## **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar.

1. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), rikujton se ajo, më 19 gusht 2014, shqyrtoi dhe miratoi Aktvendimin KK124/14.
2. Më 17 prill 2015, gjyqtari Kadri Kryeziu i dorëzoi kërkesën Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Gjykatës) që të rivendoset për të marrë pjesë në shqyrtimin e të gjitha kërkesave në Gjykatë.
3. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës ia paraqiti Gjykatës kërkesën e gjyqtarit Kadri Kryeziu.

4. Gjykata shqyrtoi dhe votoi, njëzëri, që ta miratojë kërkesën e gjyqtarit Kadri Kryeziu për të marrë pjesë në shqyrtime për të gjitha kërkesat në Gjykatë, ku përfshihen partitë politike ose individët në parti politike, apo për ndonjë rast tjetër me kontekst politik, ku një palë, *inter alia*, mund të paraqitet në procedurën në Gjykatë, siç është Presidenti i Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Avokati i Popullit dhe komunat.
5. Gjykata vëren se gjyqtari Kadri Kryeziu, gjatë qortimit të tij, ka treguar dhe ka ruajtur integritetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Profesionalizmi dhe përkushtimi i tij ndaj punës së Gjykatës kanë përmbrushur kërkesat e Gjykatës.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, më 17 prill 2015, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA MIRATOJË kërkesën e gjyqtarit Kadri Kryeziu;
- II. TË RIVENDOSË gjyqtarin Kadri Kryeziu që të marrë pjesë në shqyrtimin e të gjitha kërkesave në Gjykatë;
- III. T'IA KUMTOJË këtë vendim gjyqtarit Kadri Kryeziu dhe ta publikojë në Gazetën Zyrare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas votimit.

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

